



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.99, datë 24.12. 2018**

**MBI**

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT  
“ADANET” SH.P.K, KUNDËR MASËS ADMINISTRATIVE TË DËNIMIT ME  
GJOBË”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),  
me pjesëmarrjen e:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
4. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 24.12.2018, në mbështetje të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Rregullores së Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“SHQYRTIMI I ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT “ADANET”,  
SH.P.K, KUNDËR MASËS ADMINISTRATIVE TË DËNIMIT ME GJOBË”.**

## BAZA LIGJORE:

1. Pika 1, pika 2 germa ç e nenit 16, neni 132 e vijues të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Neni 46 i ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr.10433/2011**);
3. Neni 128 e vijues të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
4. Rregullore Nr.46 datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin Nr.2695, datë 27.10.2016 të Këshillit Drejtues;
5. Gërma c e nenit 16 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
6. Rregullore Nr.16 datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”, miratuar me vendim të Këshillit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1256, datë 16.04.2010;
7. Neni 5, 6, gërma a pika 2 e nenit 8 të Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;
8. Urdhër nr. 343, dt 07.06.2018 (nr. 1729 Prot.) “Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit”.

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankesa e sipërmarrësit “Adanet”, sh.p.k, me objekt “Anullimin e aktit administrativ të Gjobës prej 10.000 (dhjetë mijë) lekë”, me shkresën e datës 27.11.2018 (nr. 2644 Prot. i AKEP, datë 3.12.2018);
2. Projekt–Aktin “Mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “Adanet”, sh.p.k, kundër masës administrative të dënimit me gjobë”;
3. Autorizimin e Inspektimit nr.1729/1 Prot, datë 10.10.2018;
4. Procesverbalin e Inspektimit “Për Sipërmarrësit e Komunikimeve Elektronike”;
5. Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, me shkresën nr.1729/26, datë 13.11.2018 dhe gjobën me nr. 148, datë 13.11.2018;
6. Njoftimi për Vendimin Përfundimtar të Inspektimit me nr.1729/54 Prot, datë 19.11.2018;
7. Relacion shpjegues (Relacioni),

dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

### I. Në aspektin formal:

1. Ankimi i sipërmarrësit “Adanet”, sh.p.k i datës 03.12.2018, mbi gjobën e vendosur nga inspektorët e AKEP, është brenda afatit të parashikuar në nenin 136 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 3.9 të Rregullores nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 2695 datë 27.10.2016, si dhe plotëson kushtet për pranim të ankimit të parashikuara në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015).
2. Me Autorizimin e Inspektimit nr.1729/1 Prot, datë 10.10.2018, Kryetari i Këshillit Drejtues ka autorizuar inspektimin për: *“Të dhëna mbi sipërmarrësin e inspektimit”*, sipas adresës së çdo sipërmarrësi, në zbatim të Urdhrit nr. 343, dt 07.06.2018 (nr.1729 Prot.) *“Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit”*, me objekt:

Përshkrimi i objektit të inspektimit në bazë të autorizimit të inspektimit me nr.1729/1 Prot, datë 10.10.2018 ka qënë verifikimi i zbatimit të:

- a) Detyrimit mbi plotësimin dhe dërgimin e Formularit G mbi të dhënat statistikore për 3 Mujorin e dytë të vitit 2018, për sipërmarrësit sipas listës emërore:
    - “Adanet” sh.p.k
  - b) Detyrimit të raportimit të treguesve të cilësisë së 6 mujorit të parë të vitit 2018, për sipërmarrësit sipas listës emërore;
  - c) Sipërmarrësit PMR të cilët nuk kanë kryer pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave në AKEP sipas afateve, njoftimeve dhe ri njoftimeve, sipas listës emërore;
  - d) Sipërmarrësit të cilët nuk kanë kryer pagesën për caktimin dhe përdorimin e numeracionit në AKEP sipas afateve, njoftimeve dhe ri njoftimeve, sipas listës emërore;
  - e) Sipërmarrësi radio televiziv i cili nuk ka kryer pagesën në AKEP sipas afatit, njoftimit dhe ri njoftimit.
3. Në përputhje me objektin e inspektimit grupi i inspektimit, ka kryer veprimet sipas detyrave të përcaktuara dhe listës së kontrollit duke evidentuar me shkrim konstatimet si dhe çdo provë tjetër që lidhet me inspektimin.

Në bazë të konstatimeve të inspektimit mbi sipërmarrësin objekt inspektimi rezultuan shkelje të kërkesave ligjore dhe nënligjore.

4. Bazuar në faktet e konstatuara, shpjegimet dhe parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 137, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe të Rregullores Nr.46,

datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, Grupi i Inspektimit ka konstatuar se:

- Sipërmarrësi “Adanet”, Sh.p.k, me NIPT-i, L11704005D, adresa, Rr. Dervish Hima, Nr.1, Ada Tower, Kati 1, Tiranë, nga verifikimet ne distancë të grupit të inspektimit, rezulton, se sipërmarrësi nuk ka raportuar lidhur me treguesit e cilësisë për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2018.

Neni 16 i ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar t’i japin AKEP-it, me kërkesë të tij, çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur detyrimet funksionale të AKEP-it, sipas këtij ligji. Në veçanti, AKEP-i mund të kërkojë informacion, duke përfshirë publikimin e përmbledhjeve krahasuese të cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve në interes të përdoruesit. Gjithashtu,

Rregullorja Nr. 16 datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”, përcakton se: *“Të dhënat për treguesit e cilësisë se shërbimit duhet të grumbullohen dhe të llogariten mbi bazë tremujori duke nisur nga 1 Janari, 1 Prilli, etj. Sipërmarrësit duhet të dërgojnë në AKEP, deri në ditën e fundit të punës të muajit pasardhës të çdo gjashtëmujori kalendarik, një raport me informacionin për 4 nivelet e cilësisë të regjistruara mbi bazë tremujore, për secilin nga treguesit, përjashtuar rastet kur në vetë aneksin përcaktohet një kohë tjetër limit”.*

Si rezultat i mos përmbushjes së detyrimeve nga sipërmarrësi “Adanet”, Sh.p.k që rrjedhin nga, moszbatimi i nenit 16, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga moszbatimi i Rregullores Nr.16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”, dhe në mbështetje të nenit 137 pika 1, paragrafi VII të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë: VII. Me gjobë në vlerën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, për çdo shkelje tjetër të kryer nga personi juridik, të pacilësuar në pikat e mësipërme”,* për sipërmarrësin “Adanet”, sh.p.k është dhënë dënimi administrativ kryesor me “Gjobë” në vlerën **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**

## **II. Në aspektin e trajtimit në thelb të çështjes:**

Komisioni Ad Hoc i ngritur me Urdhërin nr. 589, datë 4.12.2018 *“Për ngritjen e komisionit Ad Hoc për zhvillimin e procedurës hetimore në lidhje me ankimin administrativ të sipërmarrësit “Adanet” sh.p.k, kundër aktit administrativ të dënimit me gjobë”,* pasi shqyrtoi materialet pjesë përbërëse të dosjes së inspektimit, konstatimet dhe konkluzionet e arritura në përfundim të procesit, vlerësoi se:

- i. Grupi i inspektimit në zbatim dhe konform parashikimeve të Rregullores nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” si dhe Urdhrit nr. 343, dt 07.06.2018 (nr. 1729 Prot.) ka kryer inspektimin në distancë në mënyrë të rregullt, ndaj sipërmarrësit Adanet”, sh.p.k.

- ii. Sa i takon shkeljeve të konstatuara nga inspektorët, vërehet se, sipërmarrësi “Adanet”, sh.p.k edhe pse është njoftuar paraprakisht nga strukturat e posaçme të AKEP të ngarkuara për zbatimin e detyrimeve rregullatorë, nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga gërma c) e nenit 16 të ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nga rregullorja Nr.16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”,
- iii. Duke mbajtur në konsideratë shkeljen e konstatuar, Inspektorët, bazuar në nenin 137, pika1, paragrafi VII, të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kanë të drejtë të vendosin gjobë dhe të kërkojnë marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes.
- iv. Gjoha është vendosur nga Grupi i Inspektimit, duke marrë për bazë dhe paragrafin 1/1 të nenit 137 të ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se, “Në vendosjen e gjobave sipas këtij neni do të merret parasysh: a) rëndësia dhe kohëzgjatja e kundërvajtjes; b) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; c) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë, si dhe ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi, si dhe duke marrë për bazë dhe pikën 3.14 “Kriteret për Vendosjen e Masave Administrative” të Rregullores nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.
- v. Pas marrjes së njoftimit për Vendimin Përfundimtar të Inspektimit me shkresën me nr 1729/54 Prot, datë 19.11.2018 si dhe Gjobës nr. 148, datë 13.11.2018, Sipërmarrësi “Adanet” sh.p.k i është drejtuar Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë së Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit me ankimin e datës 03.12.2018, duke kërkuar:
- revokimin e vendimit përfundimtar të inspektimit nr. 1729/26, datë 13.11.2018
  - si dhe heqjen e masës administrative “Gjobë” nr. 148, datë 01.08.2018, të vendosur nga inspektorët e AKEP, me pretendimin se: raportimi lidhur me treguesit e cilësisë për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2018 është bërë më datë 14.08.2018.
- vi. Subjekti bën me dije se ndaj tij është zhvilluar një procedurë inspektuese në muajin Gusht në përfundim të të cilës me vendim nr. 150, datë 1.08.2018, subjekti “Adanet” shpk është dënuar me masën administrative “gjobë” 10.000 (dhjete mijë lekë) pasi megjithëse subjekti Adanet nuk ka aktivitet në fushën e telekomunikacioneve duhet të kryente raportimet mbi të dhënat e cilësisë QoS në vlerën zero. Në përmbushje të këtij detyrimi “Adanet” ka paguar gjobën e vendosur si dhe ka hedhur të dhënat e mëposhtme si ato të 6 mujorit të parë ashtu edhe të 6 mujorit të dytë të 2018 brenda datës 14.08.2018.
- vii. Në përfundim të procedurës për shqyrtimin e ankimit dhe të pretendimeve të

sipërmarrësit ankimues, pas arsytiveve dhe akteve të paraqitura pranë Komisionit Ad - Hoc, si dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, konstatohet se, pretendimet e paraqitura nga sipërmarrësi në objektin e ankimit kundër dënimit administrativ me “Gjobë”, janë të pabazuara, pasi sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Detyrimet ligjore për të gjithë sipërmarrësit, përfshirë dhe sipërmarrësin “Adanet” sh.p.k, lindin që nga momenti që sipërmarrësit marrin Autorizimin nga AKEP. Për më tepër, AKEP i ka njoftuar sipërmarrësit për detyrimet e tyre në lidhje me raportimet përkatëse, që sipërmarrësit janë të detyruar ti kryejnë në zbatim të Rregullores Nr.16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”.

- viii. Si përfundim, vendosja e masës administrative me “Gjobë” me nr. 148, datë 13.11.2018, përligjet administrativisht pasi është e bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” dhe si i tillë duhet të mbetet në fuqi.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115 dhe në pikën 1 të nenit 136 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në zbatim nenit 130 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Drejtues i AKEP,

#### **V E N D O S I:**

1. Të rrëzojë ankimin administrativ të sipërmarrësit “Adanet” sh.p.k, të paraqitur me shkresën nr.2644 *Prot.* i AKEP, datë 03.12.2018.
2. Lënien në fuqi të dënimit administrativ kryesor “Gjobë”, me nr. 148, datë 13.11.2018, në shumën me vlerë 10.000 (dhjetë mijë) lekë.
3. Të njoftohet sipërmarrësi “Adanet”, sh.p.k për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatë, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Illir ZELA**

**Anëtar**

**Klarina ALLUSHI**

**Anëtar**

**Ketrin TOPÇIU**

**Anëtar**

**Edlira DVORANI**